



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Legjislatura e III-të

Nr. 24/09

Prishtinë, më 22.07.2009, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan, Hetem Arifi, Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha dhe Xhevdet Neziraj.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: moniturues nga Zyra e Presidentit, KDI, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante) dhe Gazmend Avdyli (praktikant).

Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendite te ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 17.06.2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Armët nr. L 143/1 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike L -142 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazin Natyror me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;

7. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, me amendamente;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 2007/17 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente;
10. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;**
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, propozoi që të bëhet rirenditja e rendit të ditës. Pika e 10-të, të kalojë si pika e 3-të e rendit të ditës. Pas deklarimit të anëtarëve, kryesuesi konstatoi se pika e 10-të kalonë si pika e 3-të, dhe më pas bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës sipas radhës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 17 qershor 2009

Kryesuesi, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e dt.17 qershor 2009, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente

Kryesuesi, theksoi se më mirë është të vonohet miratimi i këtij ligji, se sa të shkaktohet dëm njerëzve, kur dihet se ka pasur vërejtje për dispozitat e tij. Theksoi se kemi dy zgjidhje, e para të bëhet një shkresë ICO dhe akterët tjerë të angazhuar, për të marrë informacione se qfarë kanë punuar në këtë drejtim, dhe çështja e dytë është të vëmë në votim. Në rast të mosvotimit mund të kthehet procedura mbrapa dhe miratimi i këtij ligji mund të zgjas tri vite. Kërkoi nga anëtarët të deklarohen se si të veprohet.

Numan Balić, theksoi se është i interesuar që miratimi i këtij ligji të bëhet në një afat sa më të shpejtë. Por jo që kjo çështje të vendoset sot, për shkak se nuk jam i përgatitur. Propozoi që të kontaktohen përfaqësuesit e ICO dhe personat tjerë që janë angazhuar në këtë ligj, dhe ai të vendoset në rend dite në muajin shtator.

Kryesuesi, njoftoi se edhe po të jepte sot rekomandimet komisioni, nuk mund të radhitet në rend dite në seancë plenare, sepse për këtë sesion ka mbetur vetëm një seancë dhe për të është caktuar rendi i ditës.

Sanije Aliaj, theksoi ekzistimi i këtij ligji është në interes të të gjithë qytetarëve sepse ai rregullon pronën e paluajtshme për të gjithë qytetarët e vendit. Arsyeja e vendosjes në rend dite është bërë për faktin se Kryesia e Kuvendit me Përfundim ka kërkuar të shqyrtohet nga komisioni. Një kërkesë e këtillë më është bërë edhe në tri takime që kam përfaqësuar komisionin në mbledhjet e përbashkëta në mes kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të komisioneve. Për të punuar për këtë projektligj, është krijuar grupi punues, janë angazhuar përfaqësuesit nga Ambasada Amerikane dhe ICO, por deri me

tani nuk është mbajtur asnjë takim. Prandaj është vlerësuar e arsyeshme të shqyrtohet ai, dhe të bëhen rekomandimet për Kuvendin.

Zafir Berisha, theksoi se fakti që ky projektligj është futur në rend dite, tregon se duhet që komisioni të jap rekomandimet dhe të procedohet më tutje. Duke ditur nevojën e miratimit të këtij ligji, shpreh shqetësimin për mostrajtimi e tij nga komisioni.

Sadik Idriz, theksoi se nuk jemi të përgatitur të votojmë sot për këtë projektligj. Të vëmë kontakt me përfaqësuesit e organizatave që janë angazhuar të punojnë për këtë projektligj, dhe të presim edhe dy muaj dhe të përfundohet kjo çështje.

Hetem Arifi, përkrahu kërkesën për shtyrjen e miratimit të këtij projektligji për në shtator. Duke ditur se ky ligj i prek interesat e gjithë komuniteteve, të vihen kontaktet me përfaqësuesit ndërkombëtar që janë angazhuar për këtë projektligj, dhe më pas të procedohet për Kuvend.

Enis Kervan, theksoi se pajtohet me kryesuesin e grupit punues. z. Balic që votimi i projektligjit të shtyhet për në shtator. Por njëkohësisht pajtohet me znj. Aliaj që projektligji është futur disa herë në rend dite dhe nuk është votuar dhe proceduar për Kuvend. Prandaj të kërkohen informata zyrtare nga përfaqësuesit e ICO dhe Ambasadës Amerikane për punën e bërë në këtë projektligj, dhe pas pushimeve veriore, komisioni mund të jap rekomandimet për Kuvendin.

Xhevdet Neziraj, theksoi se nuk ka arsyetim që projektligji të futet në rend dite dhe të mos përfundohet. Të shqyrtohet ai, të trajtohen problemet që mund ti ketë dhe me rekomandim të njoftohet Kuvendi dhe komisioni funksional. Të kontaktohen përfaqësuesit e ICO dhe Ambasadës Amerikane dhe të shifet se çka kanë punuar. Shtyerja e miratimit të këtij projektligji pa arsyetim është e panevojshme.

Kosara Nikolic, theksoi se nuk ka nevojë të politizohet kjo çështje. Duke parë se jemi të papërgatitur që sot të votojmë, të shtyhet për shtator. Duke ditur se ligji prek interesa e gjithë komuniteteve, të bëjmë një punë të përbashkët, të punojmë me përfaqësuesit ndërkombëtar dhe të trajtohet çështja e këtij projektligji dhe me pas të procedohet për Kuvend..

Sanije Aliaj, theksoi se nuk ka pasur fakte për të shpjeguar Kryetarit të Kuvendit për prolongimin e këtij projektligji. Prandaj nuk ka arsyetim për prolongim.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve të bëra, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. Të vihen kontaktet zyrtare me përfaqësuesit e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) dhe Ambasadës Amerikane për marrjen e informacioneve lidhur me procesin e amendamentimit eventual të projektligjit, dhe projektligji të radhitet në rend dite për shqyrtim dhe votim në njërën nga mbledhjet e komisionit në muajin shtator, dhe komisioni të nxjerr rekomandimet për procedimin e tij në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Auditimin e Brendshëm nr. 03/L-128, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Armët nr. L 143/1 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Armët nr. L 143/1, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike L -142 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike L -142, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për Gazin Natyror me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Gazin Natyror, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për standardizimin me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për standardizimin, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturnë, Rini dhe Sport, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë së ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe pjesëmarrje të Rinisë dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 2007/17 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 2007/17, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ka konstatuar se amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

11. Të ndryshme

Sanije Aliaj, theksoi se ne raportin e komisionit lidhur me detyrat e tij ne raport me plani e veprimit, përkatësisht pika 3 dhe 4, është përcaktuar se do të realizojmë edhe dy takime në muajin korrik. Prandaj do të duhej që të zhvilloheshin këto takime.

Sadik Idriz, njoftoi se pas që jemi ne prag te pushimeve dhe te martën është seanca e fundit plenare, nuk kemi kohë, që e zhvillojmë ndonjë takim ne kete sesion. Të mbetet për në shtator.

Kryesuesi, megjë është caktuar seanca të martën, nuk kemi kohë për takime në këtë sesion. Ato do të realizohen në muajin shtator.

Enis Kervan, theksoi se takimi i paraparë me Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor nuk ka nevojë të realizohet. Ky këshill do të mbajë takime me Komisionin për Arsim dhe nëse vërejm se nuk shkon diçka në rregull mund të kyqet si komisioni. Prandaj nuk ka nevojë që tani të politizohen qështja e trashëgimisë kulturore.

Mbledhja përfundoi në ora 14:30

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Bojan STOJANOVIĆ